



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:108530

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874860

KPPP.nr.2199/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbare të kreditorit “SE-FA” Hurriyyet Mh. Menekse 2 Cd nr.44 Istanbul, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “The North Unicorn L.L.C.” me numër unik identifikues 810112166, me seli në Prishtinë, Zona Industriale “Aziz Abrashi” pn. Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arianit Koci dhe Granit Vokshi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.208/2022 të datës 21.04.2022, i lejuar nga Përmbaresi Privat Besnik H.Aliu me seli të zyrës në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “The North Unicorn” L.L.C., ashtu që Urdhri Përmbare P.nr.208/2022, i lejuar më datë 21.04.2022, nga Përmbaresi Privat Besnik H.Aliu, SHFUQIZOHET.
- II. OBLIGOHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t’ia paguaj debitorit shumën prej 104€ (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “SE-FA” Hurriyyet Mh. Menekse, ka lëshuar Urdhrin Përmbare P.nr.208/2022 të datës 21.04.2022 me të cilin e ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës së datës 19.03.2020 në shumë prej 3,840.00€, CMR të datës 23.03.2020, Faturës së datës 19.03.2020 në shumë prej 2,840.00€, me të

cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 6,680.00€ si dhe shpenzimet tjera të procedurës nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, këtë përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit si dhe regjistrimit, sekuestrimit dhe vlerësimin të paluajtshmërive.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarrimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor me arsyetimin se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarrimi nuk janë në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të cilat janë në përdorim në Republikën e Kosovës, dhe gjuha në të cilën janë hartuar faturat nuk është e kuptueshme për debitorin. Po ashtu, ka shtuar se faturat në fjalë janë të panënshkruara dhe të pavulosura nga debitori. Andaj, për këto arsye i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, dhe Urdhrin Përmbarrimor P.nr.208/2022 të datës 21.04.2022 ta shfuqizoj. Po ashtu, ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, në lartësi prej 156.00€.

Kreditori brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit ku ka theksuar se asnjëra nga kundërshtimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk përbën bazë për kundërshtim në përputhje me nenin 71 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore. Po ashtu ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim si dhe të njëjtat nuk kanë bazueshmëri në prova përkatëse. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të lë në fuqi Urdhrin Përmbarrimor P.nr.208/2022 të datës 21.04.2022.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *"Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër"*.

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Urdhrin Përmbarimor P.nr.208/2022 të datës 21.04.2022, bazohet në Faturën e datës 19.03.2020, CMR të datës 23.03.2020 dhe Faturën e datës 19.03.2020, fillimisht CMR nuk përbën dokument të besueshëm ndërkaq faturat e datës 19.03.2020 dhe 19.03.2020, nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se faturat e lartcekura, nuk janë paraqitur në kopje siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së. Rrjedhimisht, fatura si e tillë rezulton të jetë bashkangjitur shkresave të lëndës në kopje (të kopjuar) dhe jo origjinale siç kërkohet me dispozitat ligjore të LPP-së, andaj edhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit sa i përket përmbushjes së detyrimit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë çështje përmbarimore, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore, gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësuesit të debitorit në emër të prapësimit të ushtruar, në vlerë prej 104 € konform rregullores në fuqi për tarifën e avokatëve.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2199/23, datë 28.06.2024

Numri i lëndës: 2022:108530  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05874860

Gjyqtari  
Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.